



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Gjirokastër/Informacion shtesë
DVP Elbasan/Procedohen në gjendje të lirë 4 shtetas, për vepra të ndryshme penale
DVP Fier – Vihen në pranga 2 shtetas
Port, Durrës – Goditen 2 tentativa për të futur në Shqipëri, produkte ose para, pa i deklaruar
Belsh, Cërrik – Kanosi me armë gjahu, për motive të dobëta, një shtetas, kreu veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës dhe kundërshtoi punonjësit e Policisë, gjatë kontrollit të banesës, kapet dhe vihet në pranga 62-vjeçari



Lajmet

12/02/2024

Belsh, Cërrik – Kanosi Me Armë Gjahu, Për Motive Të Dobëta, Një Shtetas, Kreu Veprime Që Pengojnë Zbulimin E Së Vërtetës Dhe Kundërshtoi Punonjësit E Policisë, Gjatë Kontrollit Të Banesës, Kapet Dhe Vihet Në Pranga 62-Vjeçari

Belsh, Cërrik

Kanosi me armë gjahu, për motive të dobëta, një shtetas, kreu veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës dhe kundërshtoi punonjësit e Policisë, gjatë kontrollit të banesës, kapet dhe vihet në pranga 62-vjeçari.

Në banesën e tij, Policia gjeti dhe sekuestroi disa fishekë arme gjahu dhe materiale që shërbejnë për prodhimin në mënyrë artizanale të këtyre fishekëve.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Cërrik dhe ato të Stacionit të Policisë Belsh, menjëherë pas marrjes së njoftimit për një konflikt në fshatin Çepë, Belsh, kanë shkuar në adresën e dhënë, me parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta nga Policia, u kap dhe u arrestua në flagrancë shtetasi S. Xh., 62 vjeç, banues në fshatin Çepë, pasi dyshohet se për motive të dobëta ka kanosur me armë gjahu, shtetasin R. K., 75 vjeç, banues në fshatin Çepë.

Gjithashtu, 62-vjeçari ka kryer veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës (ka fshehur armën e gjahut) dhe ka kundërshtuar punonjësit e Policisë, për kontrollin e banesës.

Në banesën e këtij shtetasi, Policia gjeti dhe sekuestroi 32 fishekë arme gjahu dhe materiale për prodhimin në mënyrë artizanale të fishekëve për armë gjahu.

Vijon kontrolli për gjetjen dhe sekuestrimin e armës së gjahut që ka përdorur 62-vjeçari, për kanosjen.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Tiranë – Komisarati i Policisë Nr. 6 finalizon pas një pune të mirëfilltë hetimore, operacionin policor të koduar “Eleven day”

Port, Durrës – Goditen 2 tentativa për të futur në Shqipëri, produkte ose para, pa i deklaruar ▶